



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1030/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija - Ymeri , anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.SH “Portal” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.348/18, të datës 06.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.SH “Portal” me seli në Prishtinë, e datës 20.05.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.348/18, i datës 06.04.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.SH “Portal” me seli në Prishtinë si e pabazuar dhe ka mbetur ne fuqi vendimi nr.07.3/518/2015 i datës 30.01.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i kontestuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje me sugjerim që Gjykata e Shkallës së Parë të eliminoj të metat e këtij aktgjykimi dhe të vendosë meritorisht lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i

zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.07.3/518/2015 të datës 30.01.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, N.T.Sh “Portal” - Prishtinë, për rishqyrtimin e vendimeve (DUD-ave) nr.R-13419, R-13420, R-13422, R-13426 të datës 24.04.2015 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë.

Me këtë aktvendim, është konstatuar se zyra e pranimit qendror me datë 24.04.2015 subjektit në procedurë N.T.Sh “Portal” – Prishtinë, për Deklaratat Unike Doganore nr. R-13419, R-13420, R-13422, R-13426 të datës 24.04.2015 të Zyrës së Brendshme Doganore Prishtinë ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të katalogut përkatës.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 07.3/518/2015 të datës 30.01.2018. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se Gjykata e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, pasi që paditësi me rastin e doganimit të mallit sa i përket vlerës së mallit nuk ka dëshmuar dokumentacion të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave, e të cilat dokumente është obligim i paditësit - deklaruesit të mallit lëndor t’ia bashkangjes DUD-it kontestues, po ashtu paditësi – subjekti në procedurë nuk ka dëshmuar mënyrën e pagesës me prova konkrete para gjykatës në këtë konflikt administrativ. Ndërsa e paditura nga ekzaminimi fizik ka vlerësuar shkallën e demit në proporcion me dëmtimin për DUD-in R-13419/24.04.2015 është automjeti me shkallën e demit më të lartë, dhe pas ekzaminimit fizik është konstatuar shkalla e demit 30%, ndërsa për DUD-in R-13420, 13422 dhe R13426 pas ekzaminimit është konstatuar shkalla e dëmtimit 20%. Këto fakte janë vërtetuar në bazë të dokumenteve të quajtur Asycuda të cilat gjenden në shkresat e lëndës se duke marr parasysht gjendjen faktike të lëndës të marr nga katalogu i minusohet 20% dhe 30%. Gjithashtu edhe në bazë të dokumentacionit subjektit në procedurë për automjetet në fjalë nga e paditura i janë minusuar 20% për DUD-at kontestues. Prandaj, në këtë kuptim nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se Dogana e Kosovës nuk ka vlerësuar shkallën e demit mirëpo vetëm ka vlerësuar dhe ka bërë zbritjen 20% në bazë të dokumentacionit siç pretendon përfaqësuesi i paditësit, pasi në bazë të shkresave të lëndës u vërtetua fakti se e paditura pas ekzaminimit fizik të automjeteve në fjalë ka vlerësuar edhe shkallën e dëmtimit në proporcion me dëmtimin e automjeteve. Ndërsa paditësi nuk ka bërë sigurimin e provës për vërtetimin e gjendjes faktike në

momentin e zhdoganimit të automjeteve për të kundërshtuar konstatimet e të paditurës si dhe për të provuar me prova pretendimet e tij.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, po ashtu janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar e mallit është vlera e transaksionit nenit 33 të KDAK-së i cili nen parasheh që *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*. Rrjedhimisht është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i paditësit në ankesë së paditësi ka prezantuar dokumentacion valid si faturat dhe transaksionet që dëshmon çmimin e paguar të mallrave, pasi që Kolegji i kësaj gjykate gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dokument që dëshmon mënyrën e pagesës së mallit lëndor kontestues.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të

paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.1030/22, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova